

Vendim nr. 150 datë 06.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 06.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (F) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FRAN NOSHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-6, datë 11.01.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 94/ç e 95 të Kodit Civil (KC), ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 09.02.2012 mes kërkuessit, në cilësinë e huamarrësit, dhe shtetasit slloven S.R. është lidhur përpara noterës Dh.Q. kontrata e huas me nr. 727 rep. dhe nr. 150 kol., sipas së cilës shtetasi S.R. i jepte kërkuessit hua shumë prej 270.000 eurosh.

2. Duke mos qenë dakord me këtë veprim juridik, në datën 28.02.2012 kërkuessi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për konstatimin e pavlefshmërisë

së kontratës dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Ai ka pretenduar, ndër të tjera, se kontrata është bërë në mashtrim të plotë të ligjit, pasi, sipas projektkontratës fillestare “Premtim për shitje”, e cila do të nënshkruhej përpara noteres L.K., ai merrte përsipër t’i shiste shtetasi S.R. sipërfaqen e tokës prej 6.000 m², me qëllim që ky i fundit të likuidonte për llogari të kërkuarit shumë e kredisë prej 45.000 eurosh të marrë nga “Alfa Banka”, si dhe vazhdimin e marrëdhënieve të kreditimit me këtë bankë. Përmbajtja e projektkontratës është ndryshuar nga shtetasi S.R. dhe kontrata objekt mosmarrëveshjeje është nënshkruar nga kërkuari në mirëbesim, me bindjen se kishte të njëjtën përmbajtje si projektkontrata. Po sipas kërkuarit, duke qenë se të dyja subjektet e veprimit juridik janë persona fizikë me shtetësi të huaj, kontrata duhej të ishte lidhur në Slloveni, në zbatim të ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Për më tepër, noterja Dh.Q., përpara së cilës është nënshkruar kontrata, nuk ka zbatuar legjislacionin për noterinë, pasi nuk e ka informuar për përmbajtjen e saj dhe nuk e ka lexuar atë me zë të lartë përpara palëve.

3. Me vendimin nr. 2357, datë 07.03.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuarit, duke i vlerësuar si të pabazuara pretendimet e tij për lidhjen e kontratës në kushtet e mashtrimit, si dhe për zbatimin e ligjit për të drejtën ndërkombëtare private. Ajo e ka vlerësuar të rregullt kontratën e lidhur mes palëve, me të gjitha elementet e formës së saj, sipas nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Po sipas gjetjeve të gjykatës, kontrata është lexuar me zë të lartë nga noteri dhe është nënshkruar nga palët. Në këto kushte, ajo mund të kundërshtojë vetëm për falsitet, çka nuk është pretenduar nga kërkuari.

4. Për ankimin e kërkuarit, me vendimin nr. 2791, datë 24.06.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e vlerësuar atë të drejtë. Sipas gjykatës, palët kanë shfaqur vullnetin e tyre në lidhjen e kontratës së huas, gjatë përpilimit të saj noterja ka zbatuar me rigorozitet ligjin procedural dhe atë për noterinë, dhe në përfundim kontrata është nënshkruar e vulosur rregullisht nga palët.

5. Kërkuari ka ushtruar rekurs në datën 14.07.2014, duke kërkuar ndryshimin e vendimeve të gjykatës së rrethit dhe të gjykatës apelit. Me vendimin nr. 00-2023-6, datë 11.01.2023, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Sipas saj, gjykata e rrethit dhe ajo e apelit kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë; vendimet e tyre nuk janë në kundërshtim me vendime të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa pjesa e pretendimeve të parashtruara në rekurs për çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të kësaj gjykate.

6. Në datën 11.04.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuessit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

- 7.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e tij të ngritura në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit. Ato nuk kanë hetuar për mënyrën e dhënies së parave nga S.R., nëse ai kishte mundësi financiare për dhënien e huas, nëse paratë janë deklaruar në momentin e futjes së tyre në Shqipëri, si dhe nëse kontrata është deklaruar në drejtorinë e pastrimit të parave. Në gjykimin tjetër të zhvilluar në Slloveni, S.R. ka pranuar se nuk ia ka dhënë kërkuessit shumën e pretenduar të parave.
- 7.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, duke kryer një sërë shkeljesh procedurale që cenojnë standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.
- 7.3. *Barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi gjykatat nuk kanë marrë dhe vlerësuar provat e paraqitura prej tij, duke sjellë, si pasojë, pagimin e një detyrimi prej 270.000 eurosh të pamarrë përsipër. Vendimmarrja e gjykatës së rrethit bazohet kryesisht në provat e parashtruara nga pala e paditur, ndërkohë që ajo duhej të analizonte në mënyrë të gjithanshme provat dhe faktet e paraqitura nga të dyja palët. Gjykatat kanë analizuar vetëm anën formale të kontratës, duke shmangur pretendimet në lidhje me elementin subjektiv dhe qëllimin e palëve.
- 7.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij. Gjykata e apelit është mjaftuar me shprehjen se kontrata është e rregullt nga ana formale, ndërsa Gjykata e Lartë ka anashkaluar pretendimet e ngritura prej tij në rekurs. Kjo e fundit nuk është shprehur në lidhje me çështjen e kompetencës, në kushtet kur bëhej fjalë për kontratë të lidhur mes dy shtetasve të huaj.
- 7.5. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh praktikën e konsoliduar për rastet e konstatimit të pavlefshmërisë së veprimeve juridike, e veçanërisht vendimet e saj njëseuese.
- 7.6. *Standardit të hetimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi për kallëzimin penal të paraqitur prej tij për çështjen nuk ka ende një përgjigje përfundimtare.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

9. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në praktikën e saj Gjykata ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se ndërsa objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë, në përmbajtje të tij kërkuesi kundërshton edhe vendimet e gjykatave më të ulëta. Pretendimet në lidhje me këto të fundit i ka ngritur, në thelb, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ndërsa për sa u përket pretendimeve në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, vendimi i kundërshtuar i saj ka përmbyllur procesin gjyqësor për konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së huas. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, Kolegji evidenton se procesi gjyqësor në gjykatat e zakonshme ka përfunduar me vendimin nr. 00-2023-6, datë 11.01.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërsa ankimi kushtetues individual është depozituar në datën

11.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar, parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, standardit të arsytimit të vendimit dhe parimit të sigurisë juridike. Kolegji vëren se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe të parimit të sigurisë juridike nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi ai nuk ka arritur të përcaktojë, në drejtim të testit objektiv dhe subjektiv të vlerësimit kushtetues të paanshmërisë, cenimin e tij në rastin konkret ose se si vendimmarrja e Gjykatës së Lartë i ka cenuar parimin e sigurisë juridike në aspektin kushtetues. Për sa u përket pretendimeve të tjera, duke pasur parasysh thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Kolegji vlerëson t’i analizojë ato në vijim në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe standardit të arsytimit të vendimit.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit

14. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e ngritura në kërkesëpadi dhe provat e paraqitura gjatë gjykimit dhe nuk kanë dhënë përgjigje të arsyetuar në lidhje me to, duke sjellë si pasojë pagimin nga ana e tij të detyrimit prej 270.000 eurosh, të pamarrë përsipër. Vendimmarrja e gjykatës së rrethit bazohet kryesisht në provat e parashtruara nga pala e paditur, ndërkohë që ajo duhej të analizonte në mënyrë të gjithanshme provat dhe faktet e paraqitura nga të dyja palët. Gjykatat kanë analizuar vetëm anën formale të kontratës, duke shmangur pretendimet në lidhje me elementin subjektiv dhe qëllimin e palëve. Ato nuk kanë hetuar për mënyrën e dhënies së parave dhe nëse subjekti i interesuar kishte mundësi financiare për dhënien e huas, nëse paratë janë deklaruar në momentin e futjes së tyre në Shqipëri, si dhe nëse kontrata është deklaruar në drejtorinë e pastrimit të parave. Në gjykimin tjetër të zhvilluar në Slloveni, S.R. ka pranuar se nuk ia ka dhënë kërkuesit shumën e pretenduar të parave.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t’u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në

kyto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 22, datë 22.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në kërkesëpadinë drejtuar gjykatës së rrethit, kërkuuesi ka pretenduar se veprimi juridik i lidhjes së kontratës mes tij dhe shtetasit S.R. është bërë në mashtrim të plotë të ligjit; se ai ka firmosur kontratën në mirëbesim, pa e lexuar, me bindjen se kishte të njëjtën përmbajtje me projektkontratën e përpiluar përpara noteres L.K.; se noterja Dh.Q. nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit për noterinë, që parashikonin leximin me zë të lartë të kontratës në prani të palëve; se çështja duhej zgjidhur nga gjykatat e huaja bazuar në ligjin për të drejtën ndërkombëtare private; se ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit S.R. Shtetasi S.R. ka prapësuar se kontrata është hartuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Gjatë gjykimit, kërkuuesi ka paraqitur përpara gjykatës vendimin e datës 09.03.2012 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes të cilit është vendosur mosfillimi i procedimit penal ndaj shtetasit S.R., pasi nuk provohet që kërkuuesi të ketë firmosur kontratën në kushtet e mashtrimit (*shih vendimin nr. 2357, datë 07.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqet 3-4*). Në përfundim të vlerësimit të provave të paraqitura në gjykim nga të dyja palët, gjykata e rrethit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadi së kërkuetit, duke vlerësuar se nuk është mbështetur në ligj dhe në prova.

17. Krahas pretendimeve të ngritura në kërkesëpadi, në ankimin drejtuar gjykatës së apelit, kërkuuesi ka pretenduar se vendimi i gjykatës së rrethit, në pjesën që arsyeton se pretendimet e tij janë të pabazuara, është i gabuar, pasi ai ka paraqitur si provë në gjykim projektkontratën me shënimet e palës së paditur. Pas analizës së provave dhe fakteve, gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit me të njëjtat argumente, duke vlerësuar se kontrata e lidhur mes kërkuetit dhe shtetasit S.R. është e rregullt nga pikëpamja ligjore dhe se pretendimet e tij se kontrata nuk është nënshkruar për të sjellë pasoja ligjore, është i pabazuar, pasi kërkuuesi nuk ka arritur të provojë përpara gjykatës një pretendim të tillë (*shih vendimin nr. 2791, datë 24.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqet 6-7*). Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

18. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara nga kërkuuesi në rekurs për provat, të cilat kanë gjetur pasqyrim në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit ka arsyetuar se çështja e vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj; se përmes rekursit nuk mund të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave dhe se ushtrimi i kontrollit të saj rishikues nuk mund të konsistojë në vlerësim të kundërt të provave me atë të bërë nga gjykatat e faktit (*shih vendimin nr. 00-2022-6, datë 11.01.2023 të*

Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqja 3). Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit.

19. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se, në kundërshtim nga sa pretendohet, kërkuarit i është dhënë mundësia të paraqesë prova dhe argumente në mbrojtje të interesave të tij në mënyrë të barabartë me palën kundërshtare dhe nuk rezulton të jetë në kushte të disfavorshme me raport me këtë palë. Ai ka pasur mundësinë të paraqesë lirisht provat dhe të kundërshtojë pretendimet e palës kundërshtare, në garantim të plotë të parimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit. Po kështu, në këtë drejtim, Kolegji evidenton se pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual për cenimin e këtij parimi, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

20. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit

21. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij. Gjykata e apelit është mjaftuar me shprehjen se kontrata është e rregullt nga ana formale, ndërsa Gjykata e Lartë ka anashkaluar pretendimet e ngritura prej tij në rekurs. Kjo e fundit nuk është shprehur në lidhje me çështjen e kompetencës, në kushtet kur bëhej fjalë për kontratë të lidhur mes dy shtetasve të huaj.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 10, datë 04.03.2021; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Po sipas Gjykatës, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Detyrimi për garantimin e këtij standardi nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e

vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 9, datë 23.02.2023 nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, Kolegji vëren se për sa u përket pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në kërkesëpadi, në vendimin për çështjen gjykata e rrethit ka arsyetuar se pretendimet e tij për pavlefshmërinë e kontratës, për shkak se është bërë në mashtrim të plotë të ligjit, janë të pabazuara, pasi kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në këtë drejtim; me vendimin e datës 09.03.2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasit S.R., pasi nuk provohet që kërkuesi të ketë firmosur kontratën në kushtet e mashtrimit; kontrata është përpiluar në përputhje me dispozitat e ligjit për noterinë dhe të KC-së, përmban elementet e nevojshme, si dhe është lexuar me zë të lartë nga noteri. Në këto kushte ajo mund të goditet vetëm për falsitet. Po sipas gjykatës, ligji për të drejtën ndërkombëtare private ka përcaktuar rregullimin e kontratës me ligjin e zgjedhur nga palët, i cili në rastin konkret është ai shqiptar (*shih vendimin nr. 2357, datë 07.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqet 2-4*). Pretendimet e kërkuesit janë marrë në shqyrtim edhe nga gjykata e apelit, e cila, duke e gjetur vendimmarrjen e gjykatës së rrethit në zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural, i ka dhënë përgjigje të arsyetuar në lidhje me vendimmarrjen e saj (*shih vendimin nr. 2791, datë 24.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqet 6-8*). Po kështu, vendimmarrjet e këtyre gjykatave janë analizuar në vijim edhe nga Gjakata e Lartë përkundrejt pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi, duke u vlerësuar në zbatim dhe interpretim të drejtë të legjislacionit material (*shih vendimin nr. 00-2023-6, datë 11.01.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqja 13, paragrafi 17*).

25. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji vëren se në rastin konkret gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura nga kërkuesi, duke u dhënë përgjigje të argumentuar për to, në respektim të standardit të arsyetimit të vendimit. Po kështu, vendimet e gjykatave përmbajnë të dhënat e palëve, shkaqet e ngritura në padinë përmes së cilës janë vënë në lëvizje, rrethanat e faktit, pretendimet e palëve, ligjin e zbatueshëm, pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i tyre, rrjedhojë e së cilës është dispozitivi i vendimeve përkatëse. Në përmbajtje vendimet nuk rezultojnë të jenë të paqarta, kontradiktore ose në mungesë të elementeve formale.

26. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret paraprake për shqyrtimin e saj në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.